REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 janar 2018
Nr. ref.: RK 1185/18

AKVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI60/17

Parashtrues

KRU "Radoniqi" Gjakovë

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 4 të Ligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga KRU "Radoniqi" Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja), përfaqësuar nga Vjollca Kadriqeli, menaxhere e departamentit administrativ.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e nenit 4 të Ligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 4 të Ligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik nr. 04/L-139 të Procedurës Përmbarimore, me pretendimin se ndryshimi dhe plotësimi i ligjit bazik është kundërkushtetues dhe shkelë të drejtat e parashtrueses, të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 maj 2017, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 26 maj 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

7. Më 26 maj 2016, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi nga e njëjta plotësimin e kërkesës me dokumentacion relevant.

8. Më 5 qershor 2017, parashtruesja e dorëzoi formularin e kërkesës të plotësuar dhe kërkoi nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme si dhe të pezullojë zbatimin e normës së pretenduar si jokushtetuese deri në vlerësimin përfundimtar të kërkesës.

9. Më 24 tetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesja e kërkesës pohon se, me Ligjin nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore është themeluar institucioni i Përmbarimit Privat me autorizime publike për udhëheqjen e procedurës përmbarimore në shkallë të parë, me përjashtim të degës familjare dhe të drejtës së punës. Sipas nenit 5 të Ligjit në fuqi për procedurën përmbarimore organi përmbarues është Gjykata

dhe përmbaruesit privat. Duke u nisur nga kjo bazë ligjore parimet e gjyqtarit janë të obligueshme edhe për Përmbaruesin Privat i cili e udhëheqë procedurën përmbarimore në shkallë të parë. Në Ligjin nr. 04/L-139 është paraparë që shpenzimet e procedurës i paguan paraprakisht kreditori, dhe pas suksesit të procedurës i regresohen debitorit që është parim fondamental i drejtësisë nga e drejta romake që secili jurist e mëson në vit të parë të studimeve.

11. Në një datë të paspecifikuar, Ministria e Drejtësisë propozoi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-134 për Procedurën Përmbarimore. Sipas parashtrueses, me këtë ndryshim, ishte paraparë që shpenzimet fillestare të paguhen fillimisht nga kreditori e më pas të regresohen nga debitori, ndërsa tarifa e efikasitetit paguhet nga kreditori e cila nuk është tarifë fikse por që negociohet në mes Përmbaruesit Privat dhe Kreditorit, përjashtimisht paragrafit 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, organi i cili shqipton sanksion kundërvajtës me gjobë, tarifa e efikasitetit caktohet si tarifë fikse dhe i ngarkohet debitorit.

12. Më 18 prill 2017, Ligji nr. 04/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore u miratua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ky ligj, më 11 maj 2017, u shpall në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas shpalljes së tij.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me nenin 4 të Ligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik nr. 04/L-139 të Procedurës Përmbarimore i shkelen asaj të drejtat kushtetuese të mbrojtura me nenet 3, 22, 31, 54 dhe 102.2 të Kushtetutës.

14. Përkitazi me shkeljen e nenit 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, parashtruesja pretendon se, *"...Organi përmbarues duhet të jetë i paanshëm për as njërën palë, i cili parim vije në pikëpyetje në momentin që negociohen tarifat nga personi i emëruar që ushtron autorizime publike dhe në bazë të Ligjit nr. 04/L-139 neni 3 vendos për lejimin apo refuzimin e propozimit për përmbarim.*

15. Përkitazi me shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, parashtruesja mëton se, *"vetë fakti i negocimit të tarifës me njërën palë të procedurës e shkelë parimin e trajtimit të barabartë të qytetarëve dhe nxitë dyshime për keqpërdorime dhe manipulime dhe i jep procesit gjyqësor karakter të biznesit e jo të ndarjes së drejtësisë bazuar në parimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të palëve."*

16. Përkitazi me shkeljen e nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, parashtruesja pretendo se, *"...Me caktimin e tarifës të efikasitetit me marrëveshje në mes organit përmbarues dhe kreditorit dhe pagimit të tarifës së efikasitetit nga ana e kreditorit vije deri te mohimi i drejtës të garantuar me Kushtetutë ngase kreditori detyrohet që për realizimin e drejtës së tij që më parë i është mohuar padrejtësisht dhe në shumë raste ka pasur shpenzime dhe dëmtime, dhe prapë sipas ndryshimit të ligjit duhet që*

një pjesë të drejtës së tij (kredisë) ta humbë me qëllim të pagimit të tarifës së efikasitetit nëse ka sukses procedura, e cila është shkaktuar pa fajin e tij. Sipas dispozitave në fuqi të cilat janë në harmoni me Kushtetutën përkatësisht në Ligjin nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore në nenin 452, paragrafi 1 thuhet "Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblejë të gjitha shpenzimet gjyqësore edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve në nenin 279 thuhet "Shpenzimet e përmbushjes i bartë debitori, në qoftë se ato nuk i ka shkaktuar kreditori".

17. Përkitazi me shkeljen e nenit 102.4 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, parashtruesja pretendon dhe argumenton se, *"...bazuar në Ligjin në fuqi nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore neni 2, pika 1.9 dhe 1.11 dhe neni 3 organ përmbarues është Gjykata dhe Përmbaruesit Privat dhe duke u nisur nga kjo bazë ligjore parimet e gjyqtarit janë të obligueshme edhe për Përmbaruesin Privat i cili e udhëheqë procedurën përmbarimore në shkallë të parë. Nëse miratohet ndryshimi i ligjit për caktimin e tarifës së efikasitetit atëherë organi përmbarues e humb karakterin e pavarësisë dhe paanshmërisë dhe rrjedhimisht nëse Përmbaruesi Privat mund t'i negocioj tarifat atëherë mundet t'i negociojnë edhe gjyqtarët ngase është i njëjti ligj dhe duhet të vlejnë të njëjtat parime kushtetuese.*

18. Përkitazi me shkeljen e nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, parashtruesja, pretendon se, *"Sipas Nenit 22 të Kushtetutës aplikohen drejtpërdrejtë Konventa ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj dhe konventën për Mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe Lirive themelore dhe Protokollet e saj, sipas së cilave garantohen trajtimi i barabartë dhe paanshëm nga organet e drejtësisë".*

Zgjidhja e kërkuar në Gjykatë

19. Për më tepër, parashtruesja nga Gjykata kërkon: *"... të anuloj nenin 4 të Ligjit nr. 05-L-118 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore dhe të lë në fuqi nenin 13 të Ligjit bazik nr. 04/L-139. Ndryshimi i këtij neni vlerësojmë se është bërë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës se Kosovës dhe parimet e këtij akti më të lartë të shtetit si e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Barazia para Ligjit".*

20. Në fund, parashtruesja kërkon nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme për të ndaluar zbatimin e nenit 4 të Ligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, deri sa Gjykata të bie vendim përfundimtar për rastin.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

23. Gjykata po ashtu i referohet nenit 21 (4) [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."*

24. Më tej, Gjykata i referohet nenit 47.1 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik".*

25. Në fund, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (1) (a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar".*

26. Siç është përmendur më lart, thelbi i kërkesës ka të bëjë me vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 4 të Ligjit nr. 05/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-134 për Procedurën Përmbarimore, duke pretenduar se me këto plotësime dhe ndryshime të ligjit bazik, parashtrueses së kërkesës i shkelen të drejtat saj të mbrojtura me nenet 3, 22, 31, 54 dhe 102.4 të Kushtetutës.

27. Gjykata rikujton se Kushtetuta në nenin 113 të saj ka përcaktuar jurisdiksionin dhe palët e autorizuara të cilat kanë të drejtë të kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese vlerësim të kushtetutshmërisë së një norme ligjore a ligji, qoftë përmes kontrollit abstrakt apo konkret, kur pretendohet se norma a ligji është në mospajtueshmëri me ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës.

28. Gjykata, thekson se ky kontroll sipas Kushtetueses, mund të ushtrohet vetëm nga palët e autorizuara të cilat janë përmendur në paragrafët 2, 3, 4, 5, dhe 8 të nenit 113 të Kushtetutës.

29. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se "Individët" (personat fizikë dhe juridikë), sipas kuptimit të nenit 113.7 të Kushtetutës, nuk kanë të drejtë t'i drejtohen drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese dhe të kërkojnë nga e njëjta të vlerësojë *in abstrakto* kushtetutshmërinë e një norme ligjore a ligji, që

pretendohet se është në kundërshtim me ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës.

30. Prandaj, nga arsyet e sipërcekura, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës nuk është palë e autorizuar, për të kërkuar *in abstrakto* nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së normës ligjore a ligjit (shih, Aktvendimet për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në rastet e bashkuara KI20/17; KI21/17 dhe KI22/17, të 21 gushtit 2017, paragrafi 54, si dhe rastin KI92/12, të 6 dhjetorit 2012, paragrafi 15).

Kërkesa për masë të përkohshme

31. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme, për të ndaluar zbatimin e nenit 4 të Ligjit nr. 05/ L-188 për ndryshimin edhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-134, derisa Gjykata të bie vendim përfundimtar për rastin.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.2 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ..., derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit ... të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme".*

33. Gjykata, gjithashtu, merr në konsideratë nenin 27 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Gjykata Kushtetuese, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës, mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik".*

34. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 55 (4) (a) të Rregullores, që kërkon:

> *[...]*
> *(4) (a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar [...] rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
> *[...]*

35. Gjykata, vlerëson se përderisa kërkesa e parashtrueses nuk i plotëson kriteret procedurale për pranueshmëri dhe si rrjedhoje është e papranueshme, për shkak se parashtruesja nuk është palë e autorizuar, kërkesa për masë të përkohshme nuk mund të jetë më objekt shqyrtimi për Gjykatën, andaj si e tillë duhet refuzuar.

36. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa, në baza kushtetuese, nuk i përmbush kriteret procedurale të pranueshmërisë, andaj e njëjta duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 dhe 116 të Kushtetutës, të nenit 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (a), 55 (4) (a) dhe 56 (2) të Rregullores, më 23 janar 2018, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZIOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Arta Rama-Hajrizi